



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9.3.2023

Nr: 156

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR” PËR  
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË  
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 9.3.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1312 Prot., datë 3.3.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me kryetar z. Dashamir Shehi

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Dashamir Shehi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 9.3.2023 Nr: 156  
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 24.2.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me initiale “LZHK”, me kryetar z. Dashamir Shehi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me shkronja nistore “LZHK”, me adresë Rr. “Andon Zako Çajupi”, Nd.26/2, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Dashamir Shehi, me adresë, Rruga “Ali Visha”, Ndërtesa nr. 1, Ap. 3, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Suzana Gina, me adresë Rruga “Ismail Ndroqi”, 9 katëshet, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Rizaldo Vrenozi, me adresë, Rruga “Medar Shtylla”, Ndërtesa nr. 32, Hyrja Nr. 13, Ap. 26, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pranë KQZ-së, është depozituar kërkesa me nr. 1312/2 Prot., datë 7.3.2023, me anë të së cilës kryetari i partisë z. Dashamir Shehi, kërkon të regjistrohet si parti politike me emrin partia “Aleanca Progresiste LZHK” dhe jo “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” siç rezulton të jetë e regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pjesë e dokumentacionit është edhe një kërkesë e dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me objekt ndryshimin e emrit të partisë. Kërkesa mban datën 2.3.2023 dhe rezulton se nuk është marrë ende në shqyrtim nga Gjykata, si rrjedhojë nuk është e pasqyruar në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, dokumentacioni i paraqitur nga partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me kryetar z. Dashmir Shehi, me shkronjat nistore “LZHK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**